

Të kuptuarit e Shërbimeve informative



VENDI SIGURTË
BEZBEDNOMESTO
SAFE PLACE

Forumi i Iniciativës Qytetare Forum of Civic Initiative



Forumi i Iniciativës Qytetare Forum of Civic Initiative



Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) është një organizatë jo-qeveritare kosovare që promovon përfshirjen e qytetarëve kosovarë në proceset shoqërore dhe të vendimmarrjes përmes programeve të ideuara për të përqendruar vëmendjen në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.



Saferworld është një organizatë e pavarur jo-qeveritare që punon me qeveritë dhe shoqërinë civile në rrafshin ndërkombëtar për të hulumtuar, promovuar dhe zbatuar strategjitë e reja për të ngritur sigurinë e njerëzve dhe për të parandaluar dhunën e armatosur.

Të kuptuarit e
SHËRBIMEVE INFORMATIVE

Dhjetor 2006
Jérôme Mellon

Një mjet referimi
për ata që dëshirojnë
të mësojnë më shumë
për natyrën dhe rolin e
shërbimeve informative
në kontekstin evropian
të shekullit 21.

Çka është shërbimi informativ?

Shërbimi informativ është një organizatë që i kushtohet grumbullimit ose analizimit të informatave, të cilat pastaj përpunohen për t'i ndihmuar qeverisë në marrjen e vendimeve. Këto informata të përpunuara thjesht njihen si informata zbulimi dhe për të qenë efikase, informatat e zbulimit duhet të jenë me kohë, relevante, të sakta dhe parashikuese. Shërbimet informative mund të kenë fusha të ndryshme të specializimit. Për shembull, shërbimet informative të vendit, po ashtu të njohura si shërbimet e sigurisë, sigurojnë informata zbulimi që janë relevante si për sigurinë e brendshme të një vendi, ashtu edhe mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Ato zakonisht ngarkohen me grumbullimin e informatave lidhur me ata që mund të kërcënojnë sigurinë e shtetit përmes spiunazhit, sabotimit, dhunës politike, terrorizmit ose aktiviteteve të fshehta të drejtuara nga qeveritë e vendeve të huaja. Për dallim nga kjo, shërbimet informative të huaja sigurojnë informata zbulimi që janë relevante për sigurinë e jashtme të një vendi dhe bëjnë parashikimin e kërcënimeve që vijnë nga jashtë. Për shembull, një raport i informatave të shërbimit të huaj të zbulimit do të mund të këshillonte qeverinë mbi gjasat që njëra nga ambasadat e saj jashtë vendit do të sulmohet nga terroristët. Shërbimet informative penale sigurojnë informata zbulimi që janë relevante për veprimtaritë kriminale (p.sh. grupet e organizuara kriminale) dhe korrupsionin, të cilat përdoren për t'u asistuar agjencive të zbatimit të ligjit. Shërbimet informative ushtarake sigurojnë asistencë sa i përket planifikimit të mbrojtjes dhe operacioneve ushtarake. Për shembull, një raport i informatave ushtarake të zbulimit do të mund të vlerësonte anët e forta, dobësitë dhe vendndodhjen e kundërshtarit ushtarak, përpara një konflikti të hapur.

Pse ato janë të rëndësishme?

Shërbimet informative luajnë një rol shumë të rëndësishëm në analizimin e kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë kombëtare, duke i vërejtur qëllimet e kundërshtarëve të tanishëm ose të mundshëm, parashikimin e krizave të ardhshme, duke informuar në planifikim dhe operacione ushtarake, si dhe mbrojtjen e sekreteve të qeverisë. Zakonisht, asnjë entitet tjetër qeveritar nuk e ka mandatin, shkathtësitë ose resurset për t'i përmbushur funksionet e tilla kaq të rëndësishme. Për shembull, puna hetimore e shërbimeve informative britanike ka mundësuar zbulimin, parandalimin dhe ndërprerjen e një komploti të supozuar terrorist për detonimin e mjeteve shpërthyesë për t'u bartur në bordet e aeroplanëve të disa linjave ajrore që udhëtonin nga Mbretëria e Bashkuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në gusht të vitit 2006.

Cilat janë kufizimet që normalisht vihen ndaj punës së tyre?

Së pari, shërbimet informative nuk është e thënë që të bëjnë punën e policisë [siç është arrestimi i njerëzve] ose të ushtrisë [siç është lansimi i sulmeve kundër kundërshtarëve ushtarakë]. Së dyti, ato nuk është e thënë të ngacmojnë, kërcënojnë ose lëndojnë njerëz – këto veprime janë të paligjshme dhe zyrtarët e shërbimeve informative, si punëtorë të qeverisë, duhet t'i respektojnë ligjet e vendit të tyre, të drejtat dhe intimitetin e bashkëqytetarëve të tyre. Për shembull, shumicës së shërbimeve informative të shteteve demokratike moderne u ndalohet rreptësisht hetimi i akteve të avokimit të ligjshëm, protestës, ose mospajtimit, përveç nëse këto lloje të akteve janë qartazi të lidhura me kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare.

Çka përfshihet në punën e një shërbimi informativ?

Në kundërshtim me bindjen e popullarizuar, njerëzit që punojnë për shërbimet informative, zyrtarët e shërbimit informativ, pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalojnë nëpër zyra duke lexuar ose shkruar raporte dhe duke diskutuar çështje me një llojllojshmëri të gjerë njerëzish me telefon ose postë elektronike [email]. Nganjëherë ata mund edhe të takohen me këta njerëz – afaristë, udhëtarë, shkencëtarë, diplomatë – me qëllim të marrjes së informatave. Në praktikë, një shërbim informativ kalon nëpër katër faza kryesore gjatë punës së tij:

Për shembull

1. **Kërkesat:** Ministri i Punëve të Brendshme dëshiron të dijë se a duhet të rrisë kontrollin përgjatë kufirit me vendin e tij fqinj. Prandaj, ai kërkon nga drejtori i shërbimit informativ që të vlerësojë shkallën e rrezikut nga hyrja e terroristëve në vend përmes atij kufiri.
2. **Grumbullimi:** zyrtarët e shërbimit informativ i analizojnë raportet dhe statistikat lidhur me njerëzit që kalojnë kufirin dhe hyjnë në vend, dhe ata i intervistojnë udhëtarët që vijnë nga vendi fqinj. Përveç tjerash, dhe me autorizim të posaçëm të gjykatave të drejtësisë, ata i monitorojnë komunikimet telefonike të një grupi radikal nga vendi fqinj, i cili në të kaluarën shpesh ka kërcënuar se do të hedhë bomba në ndërtesat qeveritare;

3. **Analizimi:** të gjithë zyrtarët e shërbimit informativ të caktuar në këtë vlerësim i shkëmbejnë informatat e tyre, i analizojnë raportet e tyre, i dëgjojnë inçizimet e thirrjeve telefonike të përgjuara, ndërkaq konkluzionet dhe konstatimet gjegjëse i diskutojnë për të arritur një konsensus përkítazi me kërcënimin;
4. **Përhapja:** zyrtarët e shërbimit informativ, raportin përfundimtar të vlerësimit e dorëzojnë te drejtori i tyre, i cili, sipas rendit, e shpërndan atë te Ministri i Punëve të Brendshme dhe te shefi i policisë kufitare.




Figura 1:
Cikli i punës së
shërbimit informativ.

Si monitorohet puna e shërbimeve informative?

Sikur çdo agjenci tjetër qeveritare, shërbimet informative vihen nën kontrollin e politikanëve të zgjedhur, domethënë parlamentarëve. Mirëpo, për të qenë efikase, shërbimet informative duhet të jenë profesionale, apartiake dhe të pavarura nga cilado parti politike. Prandaj, roli i politikanëve kufizohet në monitorimin e aktiviteteve të shërbimeve informative në emër të popullatës, me qëllim që të sigurohen se ato nuk po shfrytëzohen si vegël e shtetit ose e një partie politike, por në vend të kësaj t'u sigurohet qytetarëve një ambient sa më i sigurt jetësor. Zakonisht, kontrolli efikas ndaj shërbimeve informative ushtrohet nga ministrat, të cilët po ashtu e kanë të drejtë të kërkojnë informata të caktuara nga këto agjenci.

Megjithëse një pjesë e punës që kryhet nga shërbimet informative është konfidenciale, parimet demokratike kërkojnë që këto shërbime, si çdo entitet tjetër qeveritar të monitorohen nga afër. Njëfarë kombinimi i këtyre parimeve të mëposhtme normalisht përdoret për të mundësuar vendosjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit demokratik:

- **Mbikëqyrja parlamentare:** aftësia e parlamentarëve për të hartuar dhe negociuar legjislacionin që lidhet me mandatin, metodat, strukturat dhe buxhetin e shërbimeve informative, si dhe për të hetuar efikasitetin e shërbimeve informative në përmbushjen e nevojave të shtetit si dhe veprimin e tyre në përputhje me ligjet dhe të drejtat e njeriut. Zakonisht, pjesa më e madhe e kësaj pune mbikëqyrëse kryhet nga komisioni i posaçëm i sigurisë ose i çështjeve të zbulimit i asamblesë parlamentare;

- **Kontrolli i brendshëm:** autoriteti, në kuadër të vet shërbimeve informative, i zyrtarëve të lartë ndaj veprimeve të vartësve të tyre, në të cilin përfshihet e drejta për të shqiptuar masa disiplinore ndaj zyrtarëve të shërbimit informativ të cilët i shkelin ligjet ose e tejkalojnë mandatin e tyre;
- **Kontrolli ekzekutiv:** detyrimi i zyrtarëve ekzekutiv përkatës ose i ministrive përgjegjëse për shërbimet informative, të cilët pastaj mund të mbahen përgjegjës për veprimet e shërbimeve informative, duke përfshirë çdo dështim dhe aktivitet të paligjshëm;
- **Shqyrtimi gjyqësor:** aftësia e gjykatave për të autorizuar disa aktivitete të caktuara informative dhe për të gjykuar pohimet për shkelje të ligjit. Ndërsa vetëm një numër i kufizuar i aktiviteteve të zbulimit, siç është përgjimi i komunikimeve, kërkon shqyrtim gjyqësor para se të zbatohet, të gjitha aktivitetet e zbulimit pa përjashtim duhet të jenë në përputhje me ligjin.
- **Mbikëqyrja e jashtme:** roli që luhet nga mediat dhe shoqëria civile në promovimin e debatit publik mbi aktivitetet e shërbimeve informative dhe dhënien e përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve. Në mbikëqyrjen e jashtme mund të përfshihet edhe një organizatë e caktuar që i kushtohet pranimit dhe procesimit anonim të ankesave nga qytetarët sa u përket veprimeve të shërbimeve informative.

A janë sekret informatat e zbulimit?

Një pjesë e punës së shërbimeve informative duhet të mbetet sekret, por jo e tëra. Ekziston një nevojë e qartë për të mbajtur njohuritë për burimet e caktuara të informatave të zbulimit, metodat dhe aktivitetet sekret nga publiku, dhe të kufizuara vetëm për numrin më të vogël të mundshëm të zyrtarëve në kuadër të qeverisë. Prapëseprapë, duhet të vendoset një baraspeshë ndërmjet nevojës për fshehtësi dhe parimit demokratik të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së shërbimeve informative, të cilat kërkojnë që parlamenti, gjyqësori dhe shoqëria e gjërë të kenë qasje në një sasi të konsiderueshme të informatave. Përveç tjerash, shumë informata që grumbullohen nga shërbimet informative nuk janë sekrete fare, duke paraqitur atë që quhet informata zbulimi nga burime të hapura. Informatat e tilla mund të grumbullohen nga librat, gazetat, interneti ose programet televizive. Së treti, raportet dhe vlerësimet e përgatitura nga shërbimet informative nuk mbahen gjithmonë sekrete. Për shembull, Shërbimi Informativ Kanadez i Sigurisë (SHIKS) rregullisht publikon raporte dhe analiza të përgatitura nga personeli i vet në faqen e vet publike të internetit. Me sa duket, këto dokumente nuk përmbajnë ndonjë informatë të ndjeshme që do të mund ta rrezikonte personelin ose operacionet e SHIKS-it, por ata përfitojnë nga njohuria dhe ekspertiza e çmueshme e personelit të kualifikuar të shërbimit informativ. Në fund, nuk është gjithmonë qenësore që një zyrtar i shërbimit informativ të mbetet sekret rreth punës së tij ose të saj. Në fakt, nuk është e pazakontë për zyrtarë të caktuar të shërbimit informativ që ta bëjnë të ditur rolin e tyre në mënyrë që informatorët potencialë të mund t'i identifikojnë më lehtë dhe t'u afrohen atyre për t'u ofruar informata.

Cilat vende kanë shërbime informative?

Vendimi për themelimin e shërbimeve informative varet nga shumë faktorë, duke përfshirë nevojat specifike të qeverisë, kërcënimet potenciale me të cilat ballafaqohet shteti dhe popullata e tij, resurset njerëzore dhe financiare në dispozicion për shërbimet e tilla informative, si dhe vullneti politik për t'u përfshirë në aktivitetet të zbulimit. Shumica e vendeve kudo në botë e kanë të themeluar së paku njërin nga katër llojet e shërbimeve informative: të vendit, të jashtëm, penal, ose ushtarak. Në disa vende, një organizatë e vetme mund të luajë rolin e dy ose më shumë shërbimeve informative, por qoftë për arsye ligjore ose për të mbrojtur specializimet dhe mandatet e ndryshme të secilit shërbim, shumica e shteteve demokratike e shmangin themelimin e shërbimeve informative që luajnë më shumë se një rol.

Çfarë është situata në Kosovë?

Për momentin, nuk ka shërbim i informativ në kuadër të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në Kosovë. Megjithatë, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Forca e Kosovës (KFOR) e Organizatës së Traktatit Veri-Atlantik (NATO) kanë një rol të kufizuar në vend sa u përket çështjeve të zbulimit, pasi që ato të dy i analizojnë informatat për të vlerësuar se cilët janë kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë së popullatës, duke përfshirë katastrofat natyrore, demonstratat e dhunshme dhe sëmundjet pandemike. Përveç tjerash, Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), i cili është ende njësi në kuadër të strukturës së Policisë Civile të UNMIK-ut, ka një rol në zbulimin e veprave penale, që luhet nga Drejtoria e Analizimit të Krimeve të SHPK-së, për të ndihmuar në hetimin dhe ndjekjen e kriminelëve. Disa organizata, siç është Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinioneve Publike (IHSOP) dhe Shërbimi Informativ i Kosovës (SHIK), janë duke operuar në atë mënyrë që ka ngjashmëri me shërbimet informative. Mirëpo, pasi që ato veprojnë në atë mënyrë pa bazë legislative dhe pa një nivel të kontrollit dhe të mbikëqyrjes nga parlamentarët, këto organizata janë ndërmarrje private dhe kështu nuk mund të konsiderohen si shërbime informative zyrtare të IPVQ-ve.

Vendi	Shërbimet Informative të Vëndit	Shërbimi Informativ i Jashtëm	Shërbimi Informativ Penal	Shërbimi Informativ i ushtarak
AUSTRIA	Drejtoria e Përgjithshme për Siguri Publike	X	Shërbimi Informativ Penal (BK)	Shërbimi Informativ Ushtarak (HNA)
KANADAJA	Shërbimi Informativ Kanadez i Sigurisë (CSIS)	Enti i Sigurisë së Komunikimeve (CSE)	Policia Mbretërore Kalorësiake Kanadeze (RCMP)	Drejtori i Përgjithshëm i Divizionit Informativ (J2/DG Int)
REBUPLIKA ES ÇEKISË		Zyra për Marrëdhënie me Jashtë dhe Informata (UZSI)	X	Agjencia Informative Ushtarake e Mbrojtjes
FRANCA	Drejtoria e Sigurisë Territoriale (DST)	Drejtoria e Përgjithshme për Siguri të Jashtme (DGSE)	Drejtoria Qendrore e Policisë Gjyqësore (DCPJ)	Drejtoria e Shërbimit Informativ Ushtarak (DRM)
GREÇIA	Shërbimi Informativ Kombëtar (EYP)	X	X	X
SLLOVENIJA	X	Agjencia Sllovene Informative dhe e Sigurisë (SOVA)	X	Shërbimi Informativ dhe i Sigurisë (VOMO)
MBRETËRIA E BASHKUAR		Shërbimi Informativ Sekret (SIS)	Agjencia e Krimeve të Organizuara Serioze (SOCA)	Shtabi Informativ i Mbrojtjes (DIS)
SHTET E BASHKUARA TË AMERIKËS	Departamenti i Sigurisë së Brendshme (DHS)	Agjencia Qendrore e Zbulimit (CIA)	Byroja Federale e Hetimeve (FBI)	Agjencia Informative e Mbrojtjes (DIA)

Tabela 1./ Disa shembuj të përzgjedhur të shërbimeve informative nëpër botë.

A duhet Kosova të themelojë shërbim informativ?

Çështja se a duhet Kosova të themelojë shërbimin e vet informativ është shtruar disa herë që nga viti 1999 dhe sërish kohëve të fundit në shtypin vendor. Përveç tjerash, projekti i Shyrtimit të Sektorit për Siguri të Brendshme (ShSSB) i ka shqyrtuar opsionet për krijimin e një shërbimi të sigurisë, i cili do t'u siguronte IPVQ-ve informata zbulimi të vendit. Derisa prietet që ShSSB-ja të paraqesë rekomandimin përfundimtar mbi këtë çështje në raportin e vet përfundimtar, Saferworld, në nëntor të vitit 2006, do të publikojë një dokument hulumtues mbi opsionet e shërbimeve të zbulimit për Kosovën në të ardhmen, i cili do të jetë në dispozicion online në <http://tinyurl.com/y7o85j>

Ku mund të gjejë më shumë informata për këtë temë?

- Susanna Bearne et al., Strukturat Vendimmarrëse të Sigurisë Kombëtare dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë, Qershor 2005, (National Security Decision-Making Structures and Security Sector Reform, June 2005), <http://tinyurl.com/y46c72>. Një raport gjithpërfshirës mbi ciklin e informatave të zbulimit, kontrollin dhe dhënien e përgjegjesisë nga shërbimet informative, si dhe legjislacionin mbi çështjet e zbulimit në kontekstin e reformës në sektorin e sigurisë, e bën atë jashtëzakonisht relevant për kontekstin aktual të Kosovës.
- Federata e Shkencëtarëve Amerikanë, Programi i Resurseve të Shërbimit të Zbulimit (Federation of American Scientists, Intelligence Resource Program), <http://tinyurl.com/3zcx>. Kjo faqe e internetit ofron një pasqyrë të përgjithshme të shpejtë të shërbimeve informative nëpër botë.

- Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, Shërbimet informative, Mars 2006 [Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces, Intelligence Services, March 2006], <http://tinyurl.com/umf6n>. Informata themelore mbi definicionin, kategoritë dhe standardet demokratike të shërbimeve bashkëkohore të zbulimit.
- Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, Shërbimet informative, Mars 2006 [Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces, Intelligence Services, March 2006], <http://tinyurl.com/yys4q4>. Informata themelore mbi rolin, rëndësinë dhe sfidat e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit.
- Greg Hannah, Kevin A. O'Brien dhe Andrew Rathmell, Çështjet e Zbulimit dhe Legjislacioni i Sigurisë për Reformën e Sektorit të Sigurisë, 2005 [Intelligence and Security Legislation for Security Sector Reform, 2005], <http://tinyurl.com/y6vnle>. Ky raport i RAND-it shqyrton rolin e shërbimeve të zbulimit në reformën e sektorit të sigurisë dhe nënvizon rëndësinë e kontrollit dhe llogaridhënies në strukturat e shërbimeve të zbulimit.
- Abram N. Shulsky dhe Gary J. Schmitt, Lufta e Heshtur [Silent Warfare]: Të Kuptuarit e Botës së Shërbimit të Zbulimit bot. 3-të, 2002 [Understanding the World of Intelligence, 3rd ed., 2002], <http://tinyurl.com/vn2og>. Njëri nga librat më të mirë dhe më në dispozicion mbi teorinë dhe konceptet e shërbimeve të zbulimit.

Çka nënkuptojmë me këto terme?

Informata zbulimi penale: informata zbulimi që janë relevante për veprimtari të kriminale (p.sh. grupet e organizuara kriminale) dhe korrupcionin, të cilat përdoret për t'u asistuar agjencive të zbatimit të ligjit.

Informata zbulimi të vendit: informata zbulimi që janë relevante si për sigurinë e brendshme të një vendi, ashtu edhe mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Kontrolli ekzekutiv: detyrimi i zyrtarëve ekzekutiv përkatës ose i ministrive përgjegjëse për shërbimet informative, të cilët pastaj mund të mbahen përgjegjës për veprimet e shërbimeve informative, duke përfshirë dështimet dhe aktivitetet e paligjshme.

Mbikëqyrja e jashtme: roli që luhet nga mediat dhe shoqëria civile në promovimin e debatit publik mbi aktivitetet e shërbimeve informative dhe dhënien e përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve.

Informata zbulimi të huaja: sigurojnë informata zbulimi që janë relevante për sigurinë e jashtme të një vendi dhe bën parashikimin e kërcënimeve të jashtme.

Informata zbulimi humane (HUMINT): kategori e informatave të zbulimit që nxjerrën nga informatat e grumbulluara dhe të siguruar nga burimet njerëzore siç janë spiunët, informatorët, udhëtarët, dhe shkencëtarët.

Informata zbulimi të imazheve (IMINT): kategori e informatave të zbulimit të nxjerra nga fotografitë dhe videot, shpesh e grumbulluar përmes përgjimeve me aeroplan ose satelit.

Informata zbulimi: informata, të cilat përpunohen për t'i ndihmuar qeverisë në marrjen e vendimeve.

Kontrolli i brendshëm: autoriteti, në kuadër të vet shërbimeve informative, të zyrtarëve të lartë ndaj veprimeve të vartësve të tyre, në të cilin përfshihet e drejta për të shqiptuar masa disiplinore ndaj zyrtarëve të shërbimit informativ të cilët i shkelin ligjet ose e tejkalojnë mandatin e tyre.

Shqyrtimi gjyqësor: aftësia e gjykatave për të autorizuar disa aktivitete të caktuara të zbulimit siç është përgjimi i komunikimeve dhe gjykimi i pohimeve për shkelje të ligjit.

Informata zbulimi të matjes dhe shenjzimit (MASINT): kategori e informatave të zbulimit të nxjerra nga analiza e të dhënave të fituara nga ndijimi i instrumenteve me qëllim të identifikimit të ndonjë karakteristike dalluese që lidhet me burimin, emituesin ose dërguesin, siç janë rrezet, radio frekuencat dhe sinjalet akustike.

Informata zbulimi ushtarake: informata zbulimi relevante sa i përket planifikimit të mbrojtjes dhe operacioneve ushtarake.

Informata zbulimi nga burimet e hapura (OSINT): kategori e informatave të zbulimit të nxjerra nga informatat që janë në dispozicion publikisht, si dhe informatat e tjera të paklasifikuara siç janë gazetat, librat, interneti dhe televizioni.

Mbikëqyrja parlamentare: aftësia e parlamentarëve për të hartuar dhe negociuar legjislacionin që lidhet me mandatin, metodat, strukturat dhe buxhetin e shërbimeve informative, si dhe për të hetuar efikasitetin e shërbimeve informative në përmbushjen e nevojave të shtetit, si dhe veprimin e tyre në përputhje me ligjet dhe të drejtat e njeriut.

Shërbimi i sigurisë: një shërbim informativ që i kushtohet grumbullimit, analizimit dhe prodhimit të informatave vendore të zbulimit.

Informata zbulimi të sinjaleve (SIGINT): kategori e informatave të zbulimit të nxjerra nga komunikimet dhe sinjalet elektronike siç janë thirrjet telefonike, radio komunikimet dhe sinjalet me radar.

Projekti Vend i Sigurtë është program pune i përbashkët i organizatave joqeveritare Saferworld dhe FIQ që mbështetë sektorin e sigurisë në Kosovë për një zhvillim të efektshëm, llogaridhënës dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit.

www.safeplaceproject.org

Saferworld

The Grayston Centre, 28 Charles Square
London N1 6HT, United Kingdom
+44 (0)20-7324-4646
www.saferworld.org.uk

Forumi i Iniciativës Qytetare

Rr. Andrea Gropa Street, 29
10000 Pristina, Kosovo
+381 (0)38-248-677
www.fiq-fci.org